



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

---

Prishtinë, 08 qershor 2012  
Nr. ref.: RK248/12

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**Rasti Nr. KI30/10**

Parashtruesi

**Belkize Mustafa**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, A.  
nr. 852/2009, të 24 marsit 2010**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar  
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Ivan Čukalović, gjyqtar  
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe  
Iliriana Islami, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Parashtruese e kërkesës është Belkize Mustafa nga Prishtina.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesja e konteston Vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, A. nr. 852/2009, të 24 marsit 2010.

## **Baza juridike**

3. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për Gjykatën Kushtetuese), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Objekti i çështjes**

4. Parashtruesja pretendon se ka pasur shkelje të nenit 3 [Barazia para Ligjit] dhe nenit 51 [E Drejta për Mbrotjtje Shëndetësore dhe Sociale] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

## **Procedura në Gjykatë**

5. Parashtruesja e dorëzoi kërkesën në Gjykatë më 7 maj 2010.
6. Më 14 shtator 2010, Kryetari e caktoi prof. dr. Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga Iliriana Islami, Gjyljeta Mushkolaj dhe Robert Carolan.
7. Më 11 dhjetor 2010 dhe më 14 janar 2011, Gjykata i dërgoi letra MPMS-së me të cilat kërkonte sqarim për disa pjesë të kërkesës.
8. Më 18 janar 2011, Gjykata mori një përgjigje nga MPMS-ja.
9. Më 16 maj 2011, pas shqyrtimit të raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri të kërkesës.

## **Përmbledhje e fakteve**

10. Më 21 tetor 2005, Departamenti i Administratës Pensionale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: DAPK), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (në tekstin e mëtejme: MPMS), nxori një vendim me të cilin parashtrueses së kërkesës i njihej e drejta në pension të aftësisë së kufizuar në mënyrë retroaktive që nga 1 janari 2004, në shumë prej dyzet euro (40 €) në muaj. Në vendim gjithashtu theksohet se 3 vjet pas fitimit të kësaj të drejte, kjo Ministri do ta ftojë znj. Mustafa për qëllime të rishqyrtimit.
11. Më 12 korrik 2007, DAPK, MPMS, duke u bazuar në vlerësimin e komisionit mjekësor i cili ka vlerësuar se tek parashtruesja e kërkesës nuk ekziston aftësia e plotë dhe e përhershme e kufizuar, ka nxjerrë një vendim me të cilin e refuzon kërkesën e znj. Mustafa për pension të aftësisë së kufizuar.
12. Më 11 dhjetor 2007, DAPK, MPMS, pas ekzaminimit të dokumentacionit, ankesave, dokumentacionit mjekësor dhe vlerësimeve të komisionit mjekësor të shkallës së parë dhe të dytë, konstatoi se nuk ka prova të mjaftueshme që znj. Mustafa i plotëson kriteret ligjore për të qenë shfrytëzuese e pensionit të aftësisë së kufizuar dhe, si rrjedhojë, nxori vendim për ta refuzuar kërkesën e saj si të pabazuar.

13. Më 27 maj 2009, Gjykata Supreme e Kosovës, në mungesë të dokumenteve dhe si rezultat i mosveprimit të MPMS-së sipas kërkesës së Gjykatës Supreme, nxori Aktgjykim A. nr. 1287/2008, me të cilin miratohej padia e znj. Mustafa e parashtruar kundër aktvendimit të MPMS-së – Këshillit të Ankesave të 11 dhjetorit 2007, duke e anuluar atë.
14. Më 5 gusht 2009, Këshilli i Ankesave për Pensione të Aftësisë së Kufizuar i DAPK, MPMS, duke vepruar në pajtim me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, A. nr. 1287/08, nxori një aktvendim me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e znj. Mustafa për njohjen e të drejtës në pension të aftësisë së kufizuar dhe e vërtetoi vendimin e komisionit mjekësor të shkallës së parë si të bazuar plotësisht në Ligjin për pensionet e personave me aftësi të kufizuara 2003/23, (në tekstin e mëtejme: LPPAK).
15. Më 24 mars 2010, Gjykata Supreme e Kosovës, në mbështetje të dokumentacionit përkatës, nxori Aktgjykim A. nr. 1287/08, me të cilin refuzohej padia e znj. Mustafa e parashtruar kundër aktvendimit të 5 gushtit 2009, të MPMS-së – Këshillit të Ankesave.
16. Në të njëjtin aktgjykim, Gjykata Supreme theksoi se komisionet mjekësore të themeluara nga MPMS-ja, në pajtim me nenin 3.2 të LPPAK-së, në përbërje të mjekëve specialistë të lëmenjve përkatës, pas vlerësimit të dokumentacionit mjekësor dhe rezultateve të shikimit të drejtpërdrejtë, kanë gjetur se tek parashtruesja e kërkesës nuk ekziston aftësia e kufizuar e plotë dhe e përhershme. Prandaj, Gjykata konstatoi se DAPK, MPMS duke e refuzuar padinë e paditëses, kanë zbatuar drejtë të drejtën materiale kur kanë konstatuar se znj. Mustafa nuk i përmbush kriteret e parashikuara me nenin 3 të LPPAK-së për ta fituar të drejtën në pension të aftësisë së kufizuar.

### **Pretendimet e parashtrueses**

17. Parashtruesja pohon që ka pasur shkelje të nenit 3 të Kushtetutës, i cili garanton barazi para ligjit.
18. Parashtruesja gjithashtu pohon që ka pasur shkelje të nenit 51 të Kushtetutës, i cili thekson se kujdesi shëndetësor dhe sigurimi social do të rregullohen me ligj.

### **Vlerësimi paraprak i pranueshmërisë së kërkesës**

19. Për të gjykuar për kërkesën e parashtrueses, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, të specifikuara më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregulloren e punës.
20. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që në përputhje me rregullin 36.1 (c), *“Gjykata mund t'i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse kërkesa është qartazi e bazuar”*.
21. Rregulli 36.2 i Rregullores së punës më tej përcakton që:

*“Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar nëse bindet se:*

*a) kërkesa nuk arsyetohet prima facie, ose*

*b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, ose*

*c) Gjykata gjen se parashtruesi nuk është subjekt i ndonjë shkeljeje të së drejtave të garantuara me Kushtetutë, ose*

d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

22. Parashtruesja e kërkesës nuk ka dorëzuar ndonjë provë *prima facie* që tregon shkeljen e të drejtave të saj sipas Kushtetutës (shih Vanek kundër Republikës së Sllovakisë, Vendimi i GJEDNJ-së për pranueshmërinë e kërkesës nr. 53363/99, i 31 majit 2005).
23. Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese përsërit që nuk është detyrë e saj, sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e apelit, apo gjykatë e shkallës së katërt, lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, *mutatis mutandis*, García Ruiz kundër Spanjës [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-1).
24. Gjykata Kushtetuese vetëm mund të shqyrtojë nëse provat para gjykatave dhe organeve të tjera janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë saqë parashtruesi i kësaj kërkesë të ketë pasur gjykim të drejtë (shih ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, Kërkesa Nr. 13071/87, i miratuar më 10 korrik 1991).
25. Në rastin konkret, parashtrueses i ishin ofruar mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e vet dhe për ta kontestuar interpretimin e ligjit, që e konsideronte të pasaktë, para MPMS-së dhe Gjykatës Supreme. Pas shqyrtimit të procedurave administrative dhe të rastit të Gjykatës Supreme si tërësi, Gjykata nuk vëren që procedurat përkatëse ishin në ndonjë mënyrë të padrejta, apo arbitrare (shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut për Pranueshmëri të Kërkesës, Nr. 17064/06, i 30 qershorit 2009).
26. Prandaj, Gjykata konkludon që kërkesa është qartazi e pabazuar në kuptim të rregullit 36 të Rregullores së punës.

### PËR KËTO ARSYE


Në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 27 të Ligjit dhe rregullin 36 të Rregullores së punës, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

### VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani

